



William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintenti

Të dashur prindër dhe kujdestarë,

Shpresoj se ky komunikim ju gjen juve dhe familjen tuaj të shëndetshëm. Drejtoria Arsimore e Filadelfias do të mbyllet për pjesën e mbetur të vitit shkollor. Megjithëse ndërtesat shkollore mbeten të mbyllura në këtë kohë, ju e dini që mësimi do të vazhdojë për nxënësit. Rishikimi dhe pasurimi me mësuesit filloi të Hënën, 20 Prill. Udhëzimet e planifikuara për Drejtorinë do të rifillojnë në 4 Maj dhe do të përfundojnë më 12 Qershor. Ndërsa kalojmë në mësimin dixhital, ne e dimë që prindërit dhe kujdestarëve u kërkohet të përfshihen në role të reja në mësimin e fëmijës së tyre. Për t'ju ndihmuar të lehtësoheni ju në këtë punë, më poshtë janë udhëzimet dhe sugjerimet:

- **Udhëzim i Planifikuar** -Duke filluar nga 4 Maj, mësuesit do të japin 3 orë / në ditë mësimdhënie të planifikuar përmes Google Classroom. Studentët në klasat K-12 do të përdorin Chromebook-et e tyre të dhënë nga Drejtoria për të marrë pjesë. Udhëzimi i Planifikuar do të përfshihet në Matematikë, Anglisht, Shkencë, Studime Sociale, Gjuhë e Huaj, Shëndet / Edukim Fizik, CTE, si dhe arsim special dhe shërbime të tjera të ngjashme. Mësimet kanë për qëllim të forcojnë mësimin e mëparshëm, të sigurojnë aktivitete pasurimi dhe të prezantojnë mësimet të reja për të gjithë studentët.
- **Google Classroom**—Google Classroom është platforma kryesore ku mësuesit do të postojnë detyra, do të zhvillojnë mësimet dhe do të komunikojnë me studentët. Disa shkolla mund të vazhdojnë të përdorin platforma të tjera të miratuara në internet si "Edgenuity" ose "Canvas".
- **Pjesëmarrja** -Të gjithë studentët kërkohet të marrin pjesë në mësimin në distancë në masën më të madhe të mundshme, duke hyrë në llogarinë e tyre të portalit studentor çdo ditë shkollore, nga e Hëna deri të Premten.
- Studentët e klasave 9 - 12 (dhe shkollat e mesme, 5 - 8 ose 6 - 8) në Engineering & Science H.S, Penn Treaty H.S, Hill FreedmanAcademy, Gamp and Masterman duhet të hyjnë në portalin e tyre çdo ditë,të drejtohen në "Assignments Due Today" për të treguar që po ndjekin dhe po marrin pjesë në kursin e asaj dite. [Student,ju lutemi shikoni linkun për udhëzimet se si të tregoni pjesëmarrjen tuaj nëpërmjet portalit.](#)
- Nje tjetër tregues i pjesëmarrjes është plotësimi dhe dërgimi i detyrave tuaja tek mësuesit.
- **Notat** — Drejtoria po zhvendoset nga katër periudha në tre. Notat përfundimtare të studentëve do të jenë mesatarisht nga tre periudhat. Studentët mund të marrin nota për detyra të reja, detyra e pa mbaruara, dhe ti bëjnë detyrat

në ose pas 4 Maj - it. Të gjithë studentët në klasat K-12 do të promovohen bazuar në udhëzimet aktuale. Nëse keni pyetje, ju lutemi kontaktoni mësuesin ose këshilltarin e fëmijës suaj.

- **Komunikimi me mësuesit** —Të gjithë mësuesit do të kenë orë të planifikuara për studentët dhe familje që të bëjnë pyetje dhe të marrin ndihmë. Mësuesi i fëmijës suaj do të komunikojë gjithashtu përmes emailit ose telefonit. Ju lutemi kontrolloni emailin tuaj rregullisht, nëse është e mundur, në mënyrë që të mos humbni mesazhe të rëndësishme.
- **Kërkesat për familjet:**
 - Komunikoni me mësuesin ose drejtorin e fëmijës së tyre nëse kanë pyetje.
 - Vendosni një vend për të mësuar në shtëpi që minimizon shpërqëndrimet dhe punën, në mënyrë të krijoni një rutinë mësimi në shtëpi, dhe të përshtateni sa më mirë situatave
 - Vendosni qëllime realiste për veten dhe fëmijën tuaj.
 - Kujtojini fëmijës suaj të komunikojë me mësuesin e tij nëse ka shqetësime ose ka nevojë për mbështetje dhe inkurajoni që të marrë pushime për ushqim të lehtë, stërvitje dhe lojëra.

Me kë të kontaktoni kur keni nevojë për ndihmë

- **Pyetje të përgjithshme:** telefononi (215) 400-5300 ose dërgoni me email në covid19info@philasd.org.
- **Notat, Kredia, Detyrat dhe Përgjigja:** drejtojuni këshilltarit ose mësuesit të fëmijës suaj. Vizitoni faqen e internetit të shkollës për të marrë informacionin e kontaktit.
- **Pyetjet e bëra më shpesh:** kontrolloni përgjigjet dhe azhurnimet e tjera në <https://www.philasd.org/coronavirus/>.
- **Problemi ose çështja në lidhje me teknologjinë:** Vizitoni qendrën e burimit të mësimi në distancë në faqen e internetit të drejtorise në <https://www.philasd.org/coronavirus/chromebooks/> ose telefononi Linjën e Ndhmës të Ndhmës për Teknologjinë e Prindërve dhe Familjeve në (215) 400-4444 ose dërgoni me email në FamilyTechSupport@philasd.org.
- **Shqetësimi social-emocional ose shqetësimi shëndetësor:** drejtohuni këshilltarit ose infermierit të fëmijës suaj. Vizitoni faqen e internetit të shkollës për të marrë informacionin e kontaktit.
- **Merrni Përditësimet:** Bashkohuni me mua @PhillySchoolsFacebook live, në internet çdo të Mërkurë në orën 3:00 pasdite, ku unë do të ndaj me ju azhurnimet për planin tonë të Vazhdimësisë së Edukimit.

Ne mezi presim kur të gjithë mund të kthehemi së bashku në shkollat dhe në zyrat tona. Drejtoria Arsimore e Filadelfias mbetet e angazhuar për të punuar së bashku me partnerët e saj për t'ju mbështetur ju dhe fëmijëve tuaj. Ju lutemi qëndroni në shtëpi sa më shumë që të jetë e mundur dhe ju lutemi të kujdeseni mirë për veten dhe të dashurit tuaj.

Sinqerisht,

A handwritten signature in black ink, reading "William R. Hite Jr." in a cursive script.

William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintenti
Rrethi Shkollor I Filadelfias